



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*  
*Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine - Ministry of Labour and Social Welfare*

---

## Udhëzues për Aplikantët

Data e hapjes së thirrjes: 15.07.2019

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 02.08.2019

## 1. PROBLEMET TË CILAT SYNOHEN TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJEJE PUBLIKE

- 1.1. Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve
- 1.2. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes

## 2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

- 2.1. Aplikuesit e pranueshëm, kush mund të aplikojë?
- 2.2. OJQ-të të cilat nuk mund të aplikojnë
- 2.3. Kufizimet në financimin e projekteve
- 2.4. Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit
- 2.5. Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
- 2.6. Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
- 2.7. Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme
- 2.8. Shpenzimet e tërthorta të pranueshme
- 2.9. Shpenzimet e papranueshme

## 3. SI TË APLIKONI?

- 3.1. Lista e formularëve të detyrueshëm, afatet dhe mënyra e kontraktimit
- 3.2. Formulari i aplikacioni të projektpropozimit
- 3.3. Përmbajtja e formës së Buxhetit
- 3.4. Ku t'a dorëzoni aplikacionin?
- 3.5. Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve
- 3.6. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

## 4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

- 4.1. Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme
- 4.2. Dokumentacion shtesë dhe kontraktimi

## 5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

## 6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

## **Thirrje publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve në fushën e shërbimeve sociale, aftësimin profesional, punësimin, pensione dhe zhvillimit të aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cenushme**

### **1. PROBLEMET TË CILAT SYNOHEN TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJEJE PUBLIKE**

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse e gjithmbarshme për hartimin e politikave sociale dhe krijimin e mundësive për punësim për qytetarët e Republikës së Kosovës. Po ashtu, duhet të sigurojë që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale, programe të punësimin dhe aftësimin profesional. Ministria është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit, standardet, planet strategjike dhe sigurimin e zbatimit të duhur të këtyre politikave dhe legjislacionit, përmes institucionet vartëse, komunave dhe organizatave tjera që ofrojnë shërbime të mirëqenies sociale dhe punësimin.

Përmes mbështetjes financiare të projekteve të OJQ-ve, synohet të rritet cilësia e shërbimeve sociale, aftësimin profesional, punësimin për grupet e cenushme, si dhe për të zgjeruar ofrimin e shërbimeve për personat që janë jashtë tregut të punës e që jetojnë në rrezik të përjashtimit social. Kategoritë të cilat do të përfitojnë janë fëmijët, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë e papunësuar, pensionistët dhe përfituesit e kategorive sociale.

Shërbimet sociale ofrohen kryesisht në nivel lokal, ku janë të përfshira: Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Qendrat për Punë Sociale (QPS), institucionet rezidenciale, si dhe rrjeti i OJQ-ve të regjistruara dhe licencuara për të mbështetur grupet e cenushme. Sistemi i shërbimeve sociale dhe familjare karakterizohet me mbulueshmëri të kufizuar për shkak të sfidave të shumta në këtë fushë. Përkundër që janë arritur rezultate në hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar, hartimin e standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve sociale si dhe licencimin e ofruesve (OJQ-ve dhe punëtorëve social), vazhdojnë sfidat dhe problemet në shtrirjen e ofrimit për të gjitha llojet e shërbimeve sociale.

Shërbimet e punësimin dhe masat aktive të tregut të punës (MATP) për të papunët dhe punëkërkuarit, ofrohen nga Agjencia e Punësimin të Republikës së Kosovës. APRK-ja i ofron shërbimet dhe masat për të papunët përmes mekanizmave të saj në nivel lokal: Zyrrave të Punësimin dhe Qendrave të Aftësimin Profesional. Zyrrat e Punësimin regjistrojnë të papunët dhe iu ofrojnë këshillime dhe ndërmjetësim në punësim të rregullt ose qasje në MATP, siç janë subvencionimi i pagës, puna praktike, etj., ndërsa Qendrat e Aftësimin Profesional ofrojnë aftësim dhe riaftësimin profesional përmes trajnimeve afatshkurtra. Sfidat ekzistojnë në përfshirjen e kufizuar të të papunëve në shërbime të punësimin dhe MATP, me fokus të veçantë tek gratë dhe të rinjtë. Aktualisht një numër i të papunëve nuk janë të regjistruar në Zyrrat e Punësimin dhe një pjesë e madhe popullatës në moshë pune janë joaktive (të papunë dhe duke mos kërkuar punë aktivisht).

Në kuadër të objektivave dhe aktiviteteve të Planit të Punës, MPMS-ja për vitin 2019 është vendosur për bashkëpunim dhe mbështetje të organizatave joqeveritare vendore të cilat do të angazhohen në realizimin e projekteve për krijimin e mundësive për trajnimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe angazhimin në programet e punësimin të përfituesve të kategorive sociale, si dhe mbështetjen e grupeve tjera të cenushme të cilët janë joaktive dhe të papunë afatgjatë.

Përmes kësaj thirrjeje publike synohet t'iu ofrohet mbështetje OJQ-ve në vazhdimin apo fillimin e zbatimit të projekteve për shërbime sociale, aftësi profesionale, punësim, për fushën e pensioneve dhe zhvillimit të aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cenueshme. Gjithashtu, synohet të rritet disponueshmëria e shërbimeve sociale, aftësimin profesional dhe punësimin për kategoritë të cilat kanë vështirësi për qasje në marrjen e shërbimeve publike të ofruara dhe menaxhuara nga MPMS-ja.

## **1.1. Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve**

*Objektivat e përgjithshme të kësaj thirrje janë:*

- Shërbime alternative për mbrojtje të fëmijëve të braktisur dhe mbështetjen e familjeve strehuese për ofrimin e shërbimeve për fëmijë;
- Shërbime rezidenciale, ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara;
- Shërbime rezidenciale, ditore dhe në familje për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare;
- Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit;
- Trajnim profesional dhe angazhim në punësim për të rriturit me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetje e të rinjve për zhvillimin e shkathtësive për qasje në tregun e punës;
- Trajnim profesional dhe angazhim në punësim për përfituesit e kategorisë së II të Skemës së Ndihmës Sociale, gratë dhe të rinjtë e papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimin;
- Ofrimi i mbështetjes në zbatimin e aktiviteteve të organizatave dhe shoqatave që merren me fushën e promovimit të të drejtave sociale për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, të burgosurit politik dhe grupet e tjera të cenuara; dhe
- Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes, këshillimeve psiko-sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.

*Objektivat specifike të kësaj thirrjeje janë:*

- Ofrimi i shërbimeve të mirëqenies së fëmijëve në qendrat rezidenciale me bazë në komunitet dhe qendrave për kujdes ditor;
- Përmirësimi i qasjes së fëmijëve dhe të rriturve në nevojë, në shërbime më cilësore në shtëpi dhe atyre rezidenciale;
- Rritja e cilësisë së shërbimeve familjare për fëmijë, persona me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar;
- Ofrimi i shërbimeve të nevojshme të parandalimit, intervenimit dhe referimit për viktimat e dhunës në familje dhe të viktimave të trafikimit;
- Ofrimi i këshillimit, ushtrimeve, përkrahjes psiko-sociale, përkrahje fizioterapeutike, përkujdesjes në shtëpi dhe shërbimeve të tjera përkatëse;
- Ofrimi i shërbimeve sociale për viktimat e dhunës në familje në kuadër të strehimoreve, duke përfshirë shërbimet mjekësore dhe sigurimin për ushqim, veshmbathje, higjienë, etj.;
- Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe përfshirja e tyre në programet e masave aktive të tregut të punës;
- Trajnimi i përfituesve të Skemës së Ndihmës Sociale dhe aktivizimi i tyre në programet e punësimin;
- Trajnimi i të rinjve të papunë afatgjatë dhe përfshirja e tyre në programet e masave aktive të tregut të punës;

- Promovimi i shërbimeve të punësimit dhe aftësimit profesional, për të rinjtë e papunë dhe gratë e papunësuar;
- Përmirësimi i kushteve të pensionistëve, përmes mbështetjes së aktiviteteve promovuese dhe avokuese për realizimin e të drejtave të tyre;
- Ofrimi i këshillimeve, përkrahjes psiko-sociale, fizioterapeutike, terapisë fizikale, terapisë logopedike, ergoterapisë, përkujdesjes, vetë-ndihmës, mbështetjes së njëri-tjetrit dhe shërbimeve të tjera përkatëse për fëmijët dhe të rriturit në nevojë;
- Ofrimi i këshillimit, ushtrimeve, përkrahjes psiko-sociale, përkrahje fizioterapeutike, përkujdesjes në shtëpi dhe shërbimeve të tjera për fëmijë dhe të rritur.

## 1.2. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes

- Për mbështetje financiare publike për projektet sipas kësaj thirrjeje publike është paraparë shuma në dispozicion prej **510,000.00** euro;
- Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e aktiviteteve të përfshira në thirrjen publike nga pika **3.1** deri **3.6** shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është **5,000** euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **15,000 euro**;
- Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e aktiviteteve të përfshira në thirrjen publike në pikën **3.7** dhe **3.8** shuma minimale e mbështetjes për një projekt është **3,000 euro**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **5,000** euro.
- Projektet mund të financohen deri në shumën prej 100% të totalit të kostove të pranueshme të projektit.
- Aplikantët dhe partnerët potencialë nuk janë të obliguar të sigurojnë bashkëfinancim, por bashkëfinancimi i konfirmuar dhe përfshirë në formularin e aplikimit, i cili kontribuon në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të projektet, do të vlerësohet si vlerë e shtuar e projektpropozimit.

## 2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

### 2.1. Aplikuesit e pranueshëm, kush mund të aplikojë?

- OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgojë kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit);
- OJQ-të aplikuese për mbështetje të projekteve sipas fushës dhe aktiviteteve të përfshira në pikën **3.1** deri **3.4** të thirrjes publike, duhet të janë të **licencuara** në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të dërgojë kopjen e licencës me rastin e aplikimit);
- Të jetë e pajisur me Numër Fiskal, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Me rastin e aplikimit OJQ-ja duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes kopjes së certifikatës së numrit fiskal;
- OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës, duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë

marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e borxheve dhe obligimeve tjera të pashlyera nuk guxon të ndikojë në implementimin e projektit, prandaj zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme;

- OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal. Prandaj, me rastin e aplikimit kërkohet një deklaratë e cila e shmang financimin e dyfishtë për aktivitetet e njëjta;
- Të kenë dorëzuar një projektpropozim sipas formularit të aplikacionit të projektit, së bashku me formularin e propozim buxhetit.

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- Të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projektpropozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- Projektpropozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe Manualit për zbatimin e Rregullores;
- Të dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimit nga ana e tyre se do të punojnë për projektin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare;
- Të dëshmojnë se kanë mision dhe përvojë në realizimin e projekteve të ngjashme duke dorëzuar statutin e OJQ/Shoqatës, apo dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën;
- Licenca për ushtrimin e veprimtarisë për fushën e shërbimeve në pikën **3.1** deri **3.4** të kësaj thirrjeje publike është e domosdoshme.

## **2.2. OJQ-të të cilat nuk mund të aplikojnë:**

OJQ-të të cilat nuk përmbushin kriteret e përgjithshme dhe kriteret specifike të përcaktuara në pikën 2.1 të këtij Udhëzuesi si dhe në nenin 10 dhe 11 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nuk mund të aplikojnë për mbështetje financiare, ose në rast aplikimi, dosja e tyre nuk do të merret për bazë në fazën e shqyrtimit dhe nuk do të kualifikohen për mbështetje financiare.

## **2.3. Kufizimet në financimin e projekteve**

OJQ-të nuk mund të përfitojnë mbështetje financiare më shumë se një (1) projekt. Po ashtu, OJQ-të të cilat janë duke zhvilluar ndonjë projekt/program të këtyre fushave të financuar nga MPMS-ja dhe kanë marrë mbështetje financiare nga ndonjë thirrje publike, apo marrëveshje të bashkëpunimit në vitin 2019, nuk mund të përfitojnë nga kjo thirrje publike.

## **2.4. Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit**

Për zbatimin e projektit nuk është e detyrueshme ekzistenca e partneritetit me organizata të tjera, por në rast të ekzistencës së partneritetit, partnerët mund të marrin pjesë më shumti në një aplikim si partnerë.

Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për aplikuesit, siç është paraparë në pikën e specifikuar 2.1 të këtij Udhëzuesi.

Organizatave joqeveritare mund të aplikojnë për mbështetje financiare të projekteve të tyre në kuadër të partneritetit me OJQ-të e tjera.

Në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet të OJQ-ve, duhet të dorëzohen deklaratat e partneritetit, ndërsa aplikuesi duhet të ketë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere.

Në rastet e propozimeve të projekteve në partneritet të OJQ-ve, duhet të merren për bazë kërkesat formale të përcaktuara në formularin 12 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Partneriteti përfshin marrëdhëniet në mes të OJQ-ve, që nënkupton përgjegjësi në zbatimin e programit/projektit të financuar nga ofruesit e mbështetjes financiare. Në mënyrë që projekti të zbatohet pa probleme, të gjitha organizatat që janë pjesë e partneritetit duhet të pajtohen me parimet e praktikës së mirë në partneritet. Kjo praktikë përfshin:

Para dorëzimit të aplikimit tek ofruesi i mbështetjes financiare, të gjithë partnerët do të lexojnë tekstin e thirrjes publike dhe udhëzimet për dorëzimin e aplikacioneve dhe të kuptojnë rolin e tyre në projekt;

Të gjithë partnerët autorizojë aplikuesin për t'i përfaqësuar ata në të gjitha marrëdhëniet me ofruesin e mbështetjes financiare në kontekstin e zbatimit të projektit;

Aplikuesi dhe të gjitha organizatat partnere do të takohen rregullisht dhe do të punojnë së bashku për zbatimin e projektit, vlerësimin dhe shqyrtimin e mënyrave për tejkalimin e sfidave dhe vështirësive në zbatimin e projektit;

Të gjithë partnerët do të marrin pjesë në përgatitjen e pasqyrave të përbashkëta përshkruese dhe të veçanta financiare dhe aplikuesi në emër të të gjithë partnerëve i paraqet ato tek ofruesi i mbështetjes financiare;

Propozimi për ndryshime në partnerët e projektit, duhet të bëhet me marrëveshje në mes të partnerëve, ndërsa aplikuesi e dorëzon atë tek ofruesi i mbështetjes financiare;

Deklarata e partneritetit (*sipas formularit të publikuar*).

## 2.5. Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

### *Periudha e zbatimit*

- Periudha e zbatimit të projektit është prej 4-6 muaj.

### *Shtrirja gjeografike e zbatimit*

- Projektet mund të zbatohen në 38 komunat e Republikës së Kosovës

### *Llojet kryesore të aktiviteteve që do të financohen përmes thirrjes publike.*

Projektet e propozuara për intervenim duhet të fokusohen në arritjen e rezultateve dhe duhet të kenë ndikim të fortë në përmirësimin e jetës së përfituesve të synuar në mënyrë të qëndrueshme ashtu, që të:

- sigurohet që përfituesit të kenë qasje më të mirë në shërbime rezidenciale me bazë në komunitet dhe në shërbime të kujdesit ditor;
- përmirësohet mirëqenia e përfituesve në qendrat e banimit dhe të kujdesit ditor me bazë në komunitet;
- sigurohet se përfituesit kanë qasje më të mjaftueshme në shërbime cilësore në familje dhe në vendbanime;
- mbështeten fëmijët dhe të rriturit të mbetur në rrugë dhe lëmshkërkues, në plotësimin e nevojave të tyre të përditshme, duke përfshirë qasjen në shërbime të kujdesit ditor, si dhe strehim;
- mbrohen fëmijët dhe të rriturit në nevojë përmes parandalimit, intervenimit dhe referimit të duhur tek shërbimet publike dhe jopublike;
- sigurohet që personat me aftësi të kufizuara të angazhohen në programet e trajnimit dhe punësimit;
- sigurohet që përfituesit nga Skema e Ndihmës Sociale të angazhohen në programet e trajnimit dhe punësimit;
- sigurohet se të rinjtë do të kanë qasje dhe angazhohen në programet e trajnimit profesional dhe angazhohen në programet e praktikës në punë dhe punësimit;
- zhvillohen aktivitete për promovimin e punësimit dhe programeve të aftësimin profesional, përmes përfshirjes së të rinjve të papunë dhe grave të papunësuar;
- ofrohet mbështetje pensionistëve për organizimin e aktiviteteve promovuese dhe avokuese për realizimin e të drejtave të tyre dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve të përkujdesjes dhe shërbimeve shëndetësore;
- ofrohet mbështetje për fëmijë dhe të rritur përmes këshillimeve, përkrahjes psiko-sociale, fizioterapeutike, terapisë fizikale, terapisë logopedike, ergoterapisë dhe përkujdesjes;
- sigurohen shërbime psiko-sociale dhe shërbime ndihmëse për fëmijë dhe të rritur që kanë nevojë të përkrahjes.

Lista e aktiviteteve të projektit nuk është e mbyllur, por vetëm ilustruese dhe do të merren parasysh për financim edhe aktivitete tjera të përshtatshme që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe specifike të thirrjes, të cilat nuk janë të përmendura në listën më lart.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, aplikanti duhet të sigurojë që të bazohet në parimin e ofrimit të mundësive të barabarta dhe jodiskriminimit, si dhe të zhvillojë veprimtari në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.



### *Aktivitetet që nuk janë të pranueshme për financim*

Llojet e veprimeve në vijim nuk janë të pranueshme:

- Të gjitha aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve sociale, aftësimin profesional, punësimin, shërbimet për pensionistë dhe realizimi i të drejtave sociale për kategoritë sociale;
- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm me avokim apo vetëdijesim edhe nëse janë nga fusha e shërbimeve sociale, aftësimin profesional, punësimin dhe pensione;
- Veprimet që nuk paraqesin një raport përfitimi për klientin, lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale, aftësimin profesional dhe punësimin për kategoritë sociale;
- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me ngritjen e kapaciteteve të personelit të projektit;
- Projektet që përmbajnë plotësisht ose kryesisht punë përgatitore ose studime;
- Projektet që mbështesin partitë politike individuale;
- Financimi kryesor i aplikuesve ose (aty ku është relevante) partnerët e tyre;
- Financimi i deficitit dhe dhënia e kapitalit;
- Subvencionet financiare për organizatat e tjera;
- Blerja e tokës, ndërtesës apo të zyrave;
- Financim retroaktiv për projektet që janë tashmë në zbatim ose që kanë përfunduar.

### **2.6 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

Përmes fondeve publike të kësaj thirrjeje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këtë Udhëzues. Në vlerësimin e projektit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

Kostoja e buxhetuar duhet të jetë reale dhe duhet të jetë e orientuar drejt kostos më efektive për arritjen e rezultateve të pritshme të aktivitetit të propozuar. Kostot e pranueshme janë kostot reale të aplikuesit të cilat përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme.

## 2.7. Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me zbatimin e disa aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

- Organizimi i aktiviteteve që ofrojnë mbështetje për personat e moshuar, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe të papunët;
- Shpenzimet e furnizimit me ushqime dhe medikamente për klientët apo persona që janë të strehuar dhe marrin shërbime të ndryshme sociale dhe familjare;
- Shpenzimet e furnizimit me material higjienik për nevoja të klientëve apo personave që marrin shërbime nga projektin;
- Shpenzimet e trajnimit dhe aftësimit profesional për personat me aftësi të kufizuara dhe përfituesit e kategorive sociale;
- Shpenzimet e përfshirjes në masa aktive të tregut të punës (praktikë në punë dhe subvencion të pagës) për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara dhe përfituesit e kategorive sociale;
- Shpenzimet e stafit menaxherial dhe profesional të angazhuar në zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke u bazuar në llojin e shërbimeve që ofrojnë dhe kohën e ndarë për zbatimin e aktiviteteve për projektin;
- Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe partnerët e përfshirë në projekt, duke specifikuar kategoritë e profesionistëve të angazhuar, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- Shpenzimet e angazhimit të trajnerëve dhe ekspertëve të angazhuar në kryerjen e aktiviteteve të projektit;
- Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj.) këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara dhe mund të financohen deri në 10% e shumës së fondeve të aprovuara nga Komisioni;
- Shpenzimet edukative dhe të aftësimit profesional për klientët dhe kategoritë përfituese që janë pjesë e projektit;
- Shpenzimet e organizimit të aktiviteteve dhe këshillime psiko-sociale për klientët dhe kategoritë përfituese që janë pjesë e projektit;
- Shpenzimet e veshëmbathjes, por duhet të jenë të specifikuar në projektpropozim me numër dhe sasi për klientët apo kategoritë përfituese që janë pjesë e projektit;
- Shpenzimet e transportit dhe derivateve, të cilat janë të planifikuara për qëllim të ngrohjeve apo vizitave në terren dhe familje (varësisht prej llojit të projektit, mund të lejohen deri në 10% e shumës së fondeve të aprovuara nga Komisioni);
- Shpenzimet e komunalive (ujë, mbeturinat, energjia elektrike dhe ngrohje) dhe mirëmbajtjes, për projektet të cilat zhvillojnë aktivitete të qëndrimit rezidencial apo ditor;
- Kosto tjera që nuk bëjnë pjesë në listën e shpenzimeve të papranueshme, të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e aktiviteteve të projektit (varësisht prej llojit të projektit mund të lejohen deri në 10% e shumës së fondeve të aprovuara nga Komisioni).

## 2.8. Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

Përveç shpenzimeve të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrjeje do të pranohen edhe kostot indirekte (mund të lejohen deri në 10% e shumës së fondeve të aprovuara nga Komisioni). Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë

kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit. Kostot e tilla duhet të specifikohen dhe të shpjegohen në formularët e aplikacionit të projektit, buxhetit dhe formularët tjerë.

## 2.9 Shpenzimet e papranueshme

*Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:*

- Taksat, shpenzimet e interesit për borxhin dhe kamatat;
- Blerja, marrja me qira ose dhënia me qira e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
- Investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
- Kostot e blerjes së pajisjeve, mobileve dhe punëve të vogla renovim (vetëm kostot e blerjeve dhe renovimeve të vogla mund të jenë të pranueshme deri në 10% e totalit të mbështetjes së aprovuar nga Komisioni);
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- Pagesa e bonuse për punonjësit;
- Detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifat për transfertat financiare dhe tarifat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
- Kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
- Blerja e pajisjeve të përdorura, makineri dhe mobilie, etj.;
- Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- Donacionet bamirëse;
- Kredi për organizata të tjera apo individë;
- Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit.

## 3. SI TË APLIKONI?

### 3.1 Lista e formularëve të detyrueshëm, afatet dhe mënyra e kontraktimit

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme, siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

- Formulari i Projektpropozimit;
- Formulari i Propozim Buxhetit;
- Formulari i Deklaratës së Partneritetit;
- Kopja e Certifikatës së Regjistrimit të OJQ-së;
- Kopja e Licencës së lëshuar nga MPMS-ja;
- Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal;
- Forma e Deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë;
- Forma e deklarimit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit;
- Deklaratë e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të deklaruara në ATK për vitin 2017 apo 2018;
- Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e obligimeve apo borxhin publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton se organizata nuk ka borxh publik apo ka ndonjë marrëveshje për shtyrje të obligimeve apo borxhit publik;
- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

*Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes, si në vijim:*

- Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarf të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar, si dhe një kopje elektronike në CD;
- Dokumentacioni që duhet dorëzuar dhe formati i tij specifikohet me këtë Udhëzues të thirrjes publike, në përputhje me kërkesat e Rregullores dhe Manualit për zbatimin e saj;
- Ofruesi i mbështetjes financiare mund të pranojë aplikacionet edhe përmes platformave elektronike, me kusht që të sigurojë konfidencialitetin dhe pacenueshmërinë e aplikacioneve që pranohen;
- Në momentin e hapjes së thirrjes publike, ofruesi i mbështetjes financiare përcakton adresën e saktë ku duhet të dorëzohet aplikacioni, si dhe datën e fillimit dhe mbarimit.

### **3.2 Formulari i aplikacioni të projektpropozimit**

Plotësimi i formularit të projektpropozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët, si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.

### **3.3 Përmbajtja e formës së buxhetit**

Forma e plotësuar e propozim buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

### **3.4 Ku t'a dorëzoni aplikacionin?**

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkuara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) të ketë të njëjtën përmbajtje, pra, të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikimi origjinal duhet të dërgohet me postë ose në mënyrë fizike të dorëzohet në Zyrën përkatëse. Në pjesën jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin *"Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues"*.

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Sheshi Miss Edit Durham nr. 46, pranë Hotel Grandit

10 000 Prishtinë, Zyra e Arkivit në MPMS.

*"Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues"*

### **3.5 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve**

Afati i thirrjes është 15 ditë pune nga data e hapjes së thirrjes dhe zgjat deri më 02 gusht 2019.

Pranohet aplikacioni i dorëzuar brenda periudhës së thirrjes publike. Gjithashtu, pranohet aplikacioni nëse vula pranuese tregon se është dorëzuar në postë deri në fund të datës së thirrjes publike, si afati i fundit për dorëzimin.

Në rast se aplikacioni është paraqitur personalisht në zyrë, aplikuesit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

### **3.6 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?**

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: [skender.jahaj@rks-gov.net](mailto:skender.jahaj@rks-gov.net), jo më vonë se 10 ditë para skadimit të thirrjes publike.

Përgjigjet ndaj kërkesave të veçanta do të dërgohen direkt në adresën e pyetjeve të shtruara dhe përgjigjet më të shpeshta do të publikohen në faqen e mëposhtme të internetit: <https://mpms.rks-gov.net/Shpalljet/Publikimet>, dhe jo më vonë se 5 ditë para skadimit të thirrjes publike.

## **4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE**

### **4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme**

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) do të themelojë një Komision Vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë, nga zyrtarë të institucionit dhe ekspertë të tjerë të jashtëm. Komisioni Vlerësues ka për detyrë të vlerësojë aplikacionet, nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të të gjitha aplikacioneve të pranuar, Komisioni do të përgatisë një listë të të gjithë aplikantëve që i plotësojnë kushtet për t'u vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Ofruesi i mbështetjes financiare (MPMS) do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit Vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni Vlerësues do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kalojë shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni Vlerësues do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve.

### **4.2 Dokumentacion shtesë dhe kontraktimi**

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikues të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, kanë hyrë në listën e përkohshme të projekteve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Komisioni Vlerësues pas pranimit të dokumentacionit shtesë do të bëjë verifikimin dhe kontrollimin e tij.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar, aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike, nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse dhe pasi të konstatohet nga institucioni se ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni Vlerësues do të propozojë listën përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

Të gjithë aplikuesit të cilët hyjnë në procesin e vlerësimit do të informohen në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve në kuadër të kësaj thirrje.

## **5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES**

*Fazat e procedurës së thirrjes;*

Afati i fundit për aplikim 02.08.2019;

Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen 19.07.2019;

Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen 23.07.2019;

Afati i fundit për verifikimin e përmbushjes së kriterëve procedurale dhe njoftimit të palëve: e papërcaktuar

Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtësore; e papërcaktuar

Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë; e papërcaktuar

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar; e papërcaktuar

Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve dhe njoftimi aplikantëve; e papërcaktuar

Afati për kontraktim; e papërcaktuar

MPMS-ja ka të drejtë të përditësojë kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit e mëposhtme: <https://mpms.rks-gov.net/Shpalljet/Publikimet>.

## **6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE**

*Formularët;*

- Formulari i aplikacionit për projekt/programit (format Word);
- Formulari i propozim buxhetit (format Excel);
- Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (format Word);
- Formulari i deklaratës së projekteve të financuara (format Word);
- Formulari i deklaratës së partneritetit (format Word)
- Formulari i vlerësimit të aplikacioneve (format Word);
- Formulari i raportit financiar (formatin Excel);